REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 18/11/2026
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera
13- | 052/01-49574

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Datë:	18.11.2026
Për:	Zyrën e Informimit
Nga:	Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë
Lënda:	**Procesverbal nga shqyrtimi publik i draft-Rregullores Komunale për Transport Rrugor në territorin e Komunës së Gllogocit**

Me 19.10.2026, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për **draft-Rregulloren Komunale për Transport Rrugor në territorin e Komunës së Gllogocit**. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, përkatësisht tek linku për konsultimet publike si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit në rrjetin social Facebook.

1. Ueb-faqja zyrtare e Komunës, në linkun e mëposhtëm:

https://gllogoc.rks-gov.net/konsultimet-publike/

2. Platforma për Konsultime Publike:

https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php

3. Faqja zyrtare e Komunës në Facebook:

https://www.facebook.com/komunadrenas

Më datë **04.11.2026** mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal.

Konsultimi publik filloi në orën 11:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit.

Konsultimin e shpalli të hapur z. Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun, lidhur me Draft-**Rregulloren Komunale për Transport Rrugor në territorin e Komunës së Gllogocit**. Ai falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe i njoftoi për qëllimin e konsultimit publik, rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike, si dhe për afatet ligjore për paraqitjen e komenteve dhe sugjerimeve. Komuna kishte bërë njoftimin publik 15 ditë më parë dhe kishte publikuar edhe linkun e draft-dokumentit, në mënyrë që secili qytetar të kishte mundësi

ta shqyrtonte përmbajtjen e tij dhe të paraqiste komentet dhe sugjerimet. Duke qenë se dokumenti është ende në fazën e draftit, qytetarët u ftuan të japin komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre, me qëllim që ato të inkorporohen në Draft-**Rregulloren Komunale për Transport Rrugor në territorin e Komunës së Gllogocit**.

Fillimisht, fjala iu dha drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (DShPE), z. Nexhmedin Gruda, e më pas shefit të sektorit, z. Afrim Prokshi, për prezantimin e draft-rregullores.

Në fjalën e tij, Drejtori i DShPE, Nexhmedin Gruda, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, si dhe grupin punues për angazhimin dhe punën e bërë gjatë hartimit të kësaj rregulloreje.

Ndërsa, Afrim Prokshi prezantoi qëllimin dhe përmbajtjen e dokumentit, duke theksuar se përmes kësaj rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe mënyra e organizimit, ushtrimit dhe mbikëqyrjes së transportit rrugor të udhëtarëve me autobusë dhe automjete taksi, si dhe transportit rrugor të mallrave në territorin e Komunës së Drenasit.
Ai theksoi se kjo rregullore përcakton, në veçanti:

a) kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit;

b) licencat dhe lejet përkatëse dhe kushtet për pajisjen me to;

c) organizimin dhe mënyrën e ushtrimit të transportit;

d) përcaktimin e linjave, itinerareve, orareve dhe vendndalimeve;

e) caktimin dhe shfrytëzimin e vendqëndrimeve dhe vendparkingjeve;

f) të drejtat dhe detyrimet e operatorëve, drejtuesve të automjeteve dhe udhëtarëve;

g) mbajtjen e evidencave dhe regjistrave;

h) mbikëqyrjen, kontrollin dhe masat në rast të shkeljes së dispozitave të kësaj Rregullorejeje; dhe

i) procedurat për ankesa dhe çështjet e tjera të përcaktuara me këtë Rregulloreje.

Pas përfundimit të prezantimit të draft-planit nga shefi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, z. Bekim Dobra hapi debatin lidhur me propozimet dhe komentet e qytetarëve.

Zekë Kluna – Administrator i fshatit Poklek dhe Vasilevë – Përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se ka paraqitur kërkesë për një linje të transportit publik me minibus për fshatin Vasilevë, pasi banorët, e veçanërisht nxënësit, po përballen me vështirësi në udhëtim për shkak të mungesës së transportit publik.

Drejtori i DShPE-së, z. Nexhmedin Gruda, tha se drejtoria ka shpallur tri herë konkurs për këtë linjë, mirëpo nuk ka pasur operatorë të interesuar për të aplikuar. Ai theksoi se, përmes kësaj rregulloreje, janë lehtësuar kushtet dhe kriteret, pasi në konkurset e mëparshme është kërkuar që operatorët të posedojnë autobusë, ndërsa tani është paraparë që transporti të mund të realizohet edhe me minibusë prej 16 udhëtarësh. Ai shprehu shpresën se, pas miratimit të rregullores dhe shpalljes së konkursit të radhës, do të ketë operatorë të interesuar për të aplikuar, në mënyrë që të zgjidhet ky problem.

Xhafer Dobërdolani – Administrator i fshatit Korroticë e Epërme – Përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se nuk ka ndonjë vërejtje lidhur me pjesën e prezantuar të rregullores. Ai shprehu mbështetjen për kërkesën

e Zekë Klunës lidhur me transportin publik për fshatin Vasilevë, duke theksuar se kësaj çështjeje duhet t'i jepet një zgjidhje, pasi shumë banorë e kanë lëshuar fshatin pikërisht për shkak të mungesës së transportit.

Shefi i DShPE-së, Afrim Prokshi, theksoi se këto kërkesa janë të drejta dhe paraqesin nevoja reale të banorëve. Megjithatë, për shkak të rritjes së çmimeve të karburanteve dhe numrit të vogël të nxënësve dhe udhëtarëve, operatorët po hezitojnë të aplikojnë për këtë linjë. Ashtu siç u përmend edhe më herët nga drejtori, konkursi është shpallur tri herë, por nuk ka pasur operatorë që kanë aplikuar. Për këtë arsye, janë lehtësuar kushtet dhe kriteret minimale, me qëllim që operatorëve t'u krijohen mundësi më të favorshme për të aplikuar.
Sa i përket mundësisë së subvencionimit, ai theksoi se aktualisht nuk ka buxhet në dispozicion për të gjetur forma të subvencionimit në këto raste. Si dhe theksoi se të njëjtin problem e kanë edhe fshatrat e tjera, si Godanci, Gurgjica dhe Likoshani. Prandaj, siç u theksua edhe më herët, janë bërë ndryshimet përkatëse në kushtet dhe kriteret e kësaj rregulloreje, me qëllim të krijimit të mundësive për funksionalizimin e linjave të transportit publik.

Pajtime Berisha – Asambleiste – Të nderuar përfaqësues të komunës dhe të nderuar pjesëmarrës të tjerë, fillimisht dua t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj. Këtë çështje e kam ngritur edhe para disa muajsh në mbledhje të Kuvendit, mirëpo ende nuk kemi ndonjë zgjidhje nga komuna. Mungesa e transportit po ua vështirëson çdo ditë e më shumë fëmijëve shkollimin, sepse ata detyrohen të vijnë me kombi deri në Drenas. Kjo paraqet rrezik për sigurinë e tyre. Shpresojmë që komuna sa më shpejt të gjejë zgjidhje për këtë problem, sepse fëmijët tanë meritojnë kushte të barabarta për arsim. Gjithashtu, për çdo kërkesë ose problem të cilin e kanë fshatrat Vasilevë dhe Poklek, pasi jam përfaqësuese e tyre, i këshilloj të drejtohen tek administratori i fshatit ose tek unë. Ju faleminderit.

Qëndresë Xhema – Asambleiste – Përshëndetje për të gjithë. Fillimisht falënderoj grupin punues për punën e jashtëzakonshme që keni bërë për këtë rregullore, që po mundoheni të gjeni zgjidhje për fshatrat që nuk janë të mbuluara me linja të transportit. Unë jam përfaqësuese për fshatin Fushticë e Poshtme, ku edhe aty kemi problem, por këtu në të kaluarën ka pasur linjë, por nuk është realizuar. A keni paraparë ndonjë mekanizëm ligjor që e rregullon këtë? Faleminderit.

Kushtrim Kastrati – Inspektor i Komunikacionit - Përshëndetje për të gjithë. Faleminderit, e nderuar. Sa i përket pjesës ku nuk realizohet plani dhe rendi i udhëtimit, sipas asaj që është vërtetuar dhe është marrë në DShPE, do të merren masa konkrete për të realizuar secilin plan rrugor të transportit publik të udhëtarëve, sipas rendit të udhëtimit të vërtetuar në drejtorinë përkatëse. Çdo operator e ka për obligim ligjor që të respektojë rendin e udhëtimit, në të kundërtën do të merren masa konkrete ndaj operatorit i cili nuk e realizon këtë pikë. Është e vërtetë që të gjitha pikat nuk mund të mbulohen, mirëpo në rastet kur hasni në këto vështirësi, ju bëj thirrje të gjithëve që të njoftoni Drejtorinë e Inspektoratit dhe do të merren masa konkrete konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Faleminderit.

Takimin e mbylli Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, z. Bekim Dobra, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre në këtë konsultim publik. Ai njoftoi se Draft-Rregullorja Komunale për Transport Rrugor në territorin e Komunës së Gllogocit (Drenasit) do të mbetet në shqyrtim publik edhe dy ditë, deri më datë 06.11.2026, në orën 16:00. Gjithashtu, bëri të ditur se të gjithë të interesuarit mund ta gjejnë draft-dokumentin në ueb-faqet dhe në linket përkatëse ku është publikuar, si dhe

t'i dërgojnë komentet dhe sugjerimet përmes dy adresave elektronike. Komentet dhe sugjerimet e pranuara do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga grupi punues, për të përcaktuar nëse janë të nevojshme ndryshimet ose plotësimet në këtë draft-dokument.
Faleminderit për pjesëmarrjen!

Konsultimi publik përfundoi në orën 11:35.

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	Njoftimi
Draft-Rregullore Komunale për Transport Rrugor në territorin e Komunës së Gllogocit (Drenasit)	Zyra e Kryetarit Zyra për Informim Zyra e Kuvendit	F M 20 18 Gjithsej 38	Salla e Kuvendit	4 komente/pytje 0 të pranuara 0 të papranuara	1. https://gllogoc.rks-gov.net/konsultimet-publike/

Bashkëngjitur me këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik;
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Përgatiti:

Bahtije Spahiu
Anëtare e Grupit Punues

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - GLLOGOC MUNICIPALITY - KOMUNA GLLOGOC - OPŠTINA GLLOGOC

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas

Lista e pjesëmarrësve në Konsultimin Publik për Draft-Rregulloren Komunale për Transport Rrugor në territorin e Komunës së Drenasit. Data e mbajtjes së konsultimit publik: 04.11.2026

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M F	Nënshkrimi
1.	Pajtime	Berisha	F	[illegible]
2.	Jetlin	Berisha	M	[illegible]
3.	QERIM I	BERBATOVCI	M	[illegible]
4.	SHABAN	BERISHA	M	[illegible]
5.	Greta	Rubovci	F	[illegible]
6.	Meqjide	Doberdolani	F	[illegible]
7.	FLORA KRASNICA	KRASNICA	F	[illegible]
8.	SHABAN	DOBRA	M	[illegible]
9.	BESART	BAJRAMI	M.	[illegible]
10.	HABIB	GASHI	M	[illegible]
11.	ZEKE	[illegible]	M	[illegible]
12.	XHAFER	DOBËRDOLANI	M	[illegible]
13.	KADRI	Ajazi	M	[illegible]
14.	Manigona	Gllanera	F	[illegible]
15.	QENDRESË	XHEMA	F	[illegible]
16.	ADELINË	DERVISHI	F	[illegible]
17.	Bahtije	Spahiu	F	[illegible]
18.	AFIJE	VESELI	F	[illegible]
19.	Arian	Krasniqi	M	[illegible]
20.	Muharet	[illegible]	M	[illegible]
21.	Kimete	Kadishani	F	[illegible]
22.	FATZINDA	ZYMBERI	F	Zymberi
23.	AVDYL	MZIU	M	[illegible]
24.	LEUTRIM	BERISHA	M	[illegible]
25.	Behim	Dobra	M	[illegible]
26.	Dafina	Leku	F	[illegible]

* *Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.*

27.	Antigona	Durmishi	F	[signature]
28.	Afrim Prdashi		M	[signature]
29.	Hexhmedin	Gruda	M	[signature]
30.	Mensur	Gllavera	M	[signature]
31.	Kushtrim	Kastrati	M	[signature]
32.	Hasime	Gashi	F	[signature]
33.	Lindore	Kastrati	F	[signature]
34.	Kosovare	Karaxha	F	[signature]
35.	Mirdita	Kastrati	F	[signature]
36.	Floriana	Hasi	F	[signature]
37.	Anjeza	Plakaj	F	[signature]
38.	Bislime	Dvorani	F	[signature]
39.				
40.				
41.				
42.				
43.				
44.				
45.				
46.				
47.				
48.				
49.				
50.				
51.				
52.				
53.				
54.				
55.				
56.				
57.				
58.				
59.				
60.				
61.				
62.				

* *Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.*